



**BASHKIMI EVROPIAN**  
 ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË /  
 PËRFAQËSUESI SPECIAL I BASHKIMIT EVROPIAN  
 SHEFI I ZYRËS

### **Plani i Veprimit Gjinator III – 2021-2025 Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën**

#### **KONTEKSTI PËR VEPRIMIN E BE-së MBI BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE NË KOSOVË**

Kosova ka bërë disa zotime ligjore dhe politike për barazinë gjinore. Në vitin 2020, Kosova zgjeroi zotimet ekzistuese ndaj Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe barazinë gjinore në [Kushtetutën](#) e saj duke përfshirë Konventën e Stambollit. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë nuk përmendet në mënyrë eksplicite në ligjet e Kosovës, por qëllimet e saj janë të përfshira në [Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#), që kanë të bëjnë me vendimmarrjen, drejtësinë, paqen, sigurinë dhe pjesëmarrjen e barabartë në sektorin e sigurisë.

[Ligji për Barazinë Gjinore](#) parashikon pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave (50%), në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike dhe publike. Ai dhe [Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#) ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi i bazuar në gjini, seks, orientim seksual dhe identitet gjinor. Ndonëse nuk përputhen me Ligjin për Barazi Gjinore, ligjet zgjedhore përfshijnë kuota për përfaqësim prej 30% të të dyja gjinive në listat e partive politike dhe në kuvendet komunale dhe atë kombëtar. [Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje](#), [Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare](#), ligji kundër [trafikimit](#), [Strategjia dhe Plani i veprimit](#) dhe [Procedurat Standarde të Veprimit](#) ekzistojnë, por kërkojnë përditësim për të siguruar përgjigjen e duhur ndaj të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, sipas Konventës së Stambollit.

Disa ligje dhe politika rregullojnë qasjen në arsimin gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues, duke përfshirë [Ligjin për Arsimin Parashkollor](#), [Ligjin për Arsimin në Komuna](#), [Ligjin për Arsimin Parauniversitar](#), dhe [Ligjin për Arsimin e Lartë](#). [Ligji i Punës](#) ndalon diskriminimin në punësim, rekrutim, trajnim, promovim, masa disiplinore dhe kushte punësimi, por duhet të harmonizohet me *acquis* të BE-së, veçanërisht me Direktivën e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës. [Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë](#) i detyron punëdhënësit të sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit, veçanërisht gratë shtatzëna, gratë gjdhënëse dhe personat me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht kuadrit ligjor relativisht gjithëpërfshirës, zbatimi mbetet i dobët. Pabarazitë gjinore vazhdojnë në të gjithë sektorët që lidhen me Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA) I. Gratë në zona rurale, me aftësi të kufizuara dhe të pakicave etnike (veçanërisht boshnjakët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët), si dhe personat LGBTQI shpesh përballen me [barriera dhe pabarazi të shtuara](#).

Gratë, veçanërisht gratë e pakicave etnike, mbeten të nënpërfaqësuara në parlament (36.6%), kuvende komunale (35%), qeveri (nën 34% të ministrave në të gjitha zgjedhjet dhe vetëm 20% të zëvendësministrave që nga viti 2008), në administratë publike (44% të nëpunësve civilë në nivel qendror, 33% në nivel lokal, 0 gra kryetare komunash në periudhën 2017-2021), dhe në institucione të drejtësisë, veçanërisht në pozita vendimmarrëse. Përkundër shprehjeve të përkushtimit ndaj Rezolutës 1325 të KS të OKB-së, gratë dhe prioritetet e grave kanë qenë të nënpërfaqësuara në dialogun Prishtinë-Beograd.

Dhuna me bazë gjinore, që prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat, mbetet e përhapur, e rënduar nga një rritje globale e gjuhës së urrejtjes, retorika përçarëse që synon gratë dhe vajzat, bullizmi kibernetik, tensionet ndëretnike dhe diskriminimi ndaj pakicave dhe grupeve të marginalizuara. Dhuna në familje është rritur gjatë COVID-19. Martesat e hershme ende prekin disa vajza rome, ashkali, egjiptiane dhe ato në zona rurale. Reagimi institucional ndaj dhunës dhe qasja në drejtësi janë përmirësuar, por mangësitë vazhdojnë. Shërbimet e rehabilitimit dhe riintegritit mungojnë. Financimi është i pamjaftueshëm.

Mësimdhënësit rrallë ofrojnë arsim adekuat në lidhje me të drejtat seksuale dhe riprodhuese. Mes sistemit tashmë të brishtë të kujdesit shëndetësor, qasja në kujdes shëndetësor cilësor është përkeqësuar gjatë COVID-19.

Burimet e pamjaftueshme njerëzore, infrastruktura e dobët, joprofesionalizmi i punonjësve shëndetësorë, praktikat kulturore dhe ndërgjegjësimi i dobët, të gjitha paraqesin sfida.

Ndërsa shkalla e braktisjes së shkollës së mesme të lartë është e ulët, djemtë përbënin 79% të braktisjes në 2018/2019. Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët, [sidomos vajzat](#), kanë më shumë gjasa të ndërpresin arsimin ndërmjet shkollës së mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Vajzat janë të nënpërfaqësuar në shkollat profesionale (42%) dhe djemtë në gjimnaze (42%). Rolet dhe stereotipet tradicionale gjinore në lidhje me profesionet e përshtatshme për gratë dhe burrat kontribuojnë në zgjedhjet arsimore dhe nënpërfaqësimin e tyre përkatës në sektorë të caktuar. Gratë janë të nënpërfaqësuar në mesin e sipërmarrësve dhe pronarëve të bizneseve, pasi ato përballen me sfida të shtuara: qasje të dobët në kapital, role tradicionale gjinore dhe diskriminim. Në Kosovë, [79% e grave](#) janë joaktive në tregun e punës (as nuk punojnë dhe as nuk kërkojnë punë). Faktorët kryesorë përfshijnë punën e kujdesit pa pagesë, objektet e pamjaftueshme të kujdesit të përbalueshëm dhe diskriminimin në punësim mes dispozitave aktuale të pushimit të lehonisë, ku punëdhënësit paguajnë për gjashtë muaj pushim. COVID-19 ka prekur gratë [në mënyrë disproporcionale; 22% e grave, dhe asnjë burrë, raportuan se kryenin detyrat familjare](#) të kujdesit në vend që të kërkonin punë.

Pavarësisht përmirësimeve të vogla, gratë përbëjnë vetëm 18% të të gjithë pronarëve të pronave. Në vitin 2019, [80% e qytetarëve besuan](#) se gratë dhe burrat duhet të kenë të drejta të barabarta për pronësinë e pronës, krahasuar me 42% në vitin 2015. Tradita mbetet një nga [sfidat kryesore](#) për pronësinë e pronës së grave. Gratë shpesh humbasin pronën dhe të drejtat e trashëgimisë, gjë që pengon qasjen e tyre në kapital. Ekziston një analizë e kufizuar e thelluar gjinore në lidhje me ndryshimet klimatike, mjedisin dhe digjitalizimin. Të dhënat sugjerojnë se gratë janë të nënpërfaqësuar në këta sektorë.

Plani i zbatimit në nivel vendi për Kosovën është bazuar në analizat ekzistuese të konfliktit që janë të ndjeshme nga aspekti gjinor, në [Analizën Gjinore të BE-së](#) në Kosovë (2018), dhe në profilin e përditësuar gjinor të BE-së që përputh objektivat e GAP III me draft Kornizën Programuese të IPA III.<sup>1</sup> Objektivat e GAP III të propozuara për zbatim në Kosovë përputhen me [Programin e Kosovës për Barazi Gjinore \(PKBGj\) 2020-2024](#). PZNV-ja gjithashtu bazohet në konsultimet me palët e interesit, duke përfshirë brenda Zyrës së BE-së në Kosovë, Përfaqësuesin Special të BE-së (PSBE), Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), Shtetet Anëtare të BE-së, OKB-në, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Forcën e Kosovës (KFOR) dhe donatorë të tjerë dhe organizata ndërkombëtare. Gjithashtu janë mbajtur konsultime me institucionet kyçe si Agjencia për Barazi Gjinore dhe Departamenti për Integritim Evropian në Zyrën e Kryeministrit, si dhe me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), duke përfshirë organizatat për të drejtat e grave, mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave dhe ndërtuesit e paqes.

## FUSHAT E PËRZGJEDHURA TEMATIKE TË ANGAZHIMIT DHE OBJEKTIVAT

Fushat e mëposhtme tematike të angazhimit dhe objektiveve nga GAP III janë përzgjedhur për Kosovën. Ato janë të harmonizuara me draft Kornizën e Programimit IPA III. Të gjitha referencat për "diversitetin" në objektiva nënkuptojnë se BE-ja do të marrë parasysh pozicionet dhe nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve të zonave të ndryshme gjeografike, etnive, aftësive, orientimeve seksuale dhe identiteteve gjinore, ndër të tjera. BE-ja do t'i arrijë këto objektiva përmes dialogut politik dhe programeve në disa sektorë, në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë, ministritë e linjës, komunat, mekanizmat kombëtarë të barazisë gjinore (Agjencia për Barazi Gjinore, zyrtarët për barazi gjinore) dhe shoqërinë civile, veçanërisht OSHC-të e grave.



### LIRI NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE

Objektivat e GAP III të Fushës Tematike 1 kanë të bëjnë me IPA III në lidhje me sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë dhe do të kontribuojnë në zbatimin e zotimeve kushtetuese të Kosovës ndaj Konventës së Stambollit dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, Objektivit specifik 3.1:

<sup>1</sup> Përderisa sipas udhëzimeve zyrtare nga Komisioni Evropian, PZNV-ja duhet të harmonizohet me Programin Indikativ Shumëvjeçar (MIP), Kosova nuk e ka një të tillë. Në kohën e hartimit të kësaj PZNV-je, rregullorja IPA III ende nuk ishte miratuar, kështu që kjo bazohet në dritaret e financimit të parapara tentativisht në draft Kornizën e Programit IPA III.

- “1. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, me gjithë diversitetin e tyre, mbrohen më mirë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në sferën publike dhe private, në vendin e punës dhe në internet nëpërmjet legjislationit dhe zbatimit efektiv”. BE-ja do ta arrijë këtë përmes dialogut politik, shqyrtimit legjislativ, monitorimit të zbatimit ligjor, programeve të financuara nga BE-ja për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, Programin IPA për Shoqërinë Civile dhe Media (CSFMP) dhe Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR). EULEX-i do të vazhdojë të monitorojë dhe raportojë mbi trendet e qasjes në drejtësi për personat që pësojnë dhunë me bazë gjinore, duke u angazhuar në rishikimin legjislativ dhe për të avancuar kapacitetet e institucioneve. BE-ja do të sinergjizojë përpjekjet e saj me Këshillin e Evropës (KiE), UN Women (me OSHC-ët), USAID-in, Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Shoqërinë Gjerman për Zhvillim (GIZ).
- “2. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, janë agjentë të ndryshimit në lidhje me normat sociale diskriminuese, stereotipet gjinore dhe nxitësit gjinor të konfliktit” përmes mbështetjes IPA, Programi IPA për Shoqërinë Civile dhe Median-CSFMP dhe Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut-EIDHR, në bashkëpunim me EULEX-in, UNDP-në, Holandën, Slloveninë, Sida-n dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA.
- “3. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, që përjetojnë dhunë me bazë gjinore, kanë qasje të shtuar në shërbimet thelbësore”, përmes amendamenteve ligjore të mbështetura nga BE-ja, si dhe sundimit të ligjit dhe Programit IPA për Shoqërinë Civile dhe Median- programe të CSFMP. EULEX-i do të monitorojë dhe raportojë për reagimin e institucioneve ndaj dhunës me bazë gjinore dhe kapaciteteve të mëtejshme të ofruesve të shërbimeve. BE-ja do të sinergjizojë përpjekjet me KiE-në, Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA, Sida-n, UN Women (me OSHC-ët), UNDP-në dhe GIZ-in.
- “5. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në të gjithë diversitetin e tyre të trafikuar për të gjitha format e shfrytëzimit dhe abuzimit kanë përmirësuar qasjen në shërbime adekuate dhe cilësore për integrimin socio-ekonomik dhe mbështetjen psiko-sociale”, përmes Programit IPA për Shoqërinë Civile dhe Media-CSFMP, Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut-EIDHR, dhe EULEX-it.
- “6. Organizatat për të drejtat e grave, lëvizjet sociale dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile janë me ndikim në dhënien fund të dhunës me bazë gjinore”, përmes dialogut politik dhe Programit të IPA-s për Shoqërinë Civile dhe Media-CSFMP. Kjo do të jetë në koordinim me UN Women, Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA, Sida-n dhe GIZ-in.
- “7. Të dhëna cilësore, të ndara sipas gjinisë dhe të krahasueshme globalisht për forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe praktikat e dëmshme mblidhen dhe përdoren gjithnjë e më shumë për të informuar ligjet, politikat dhe programet”, të mbështetura përmes sundimit të ligjit dhe veprimeve të UN Women (me OShC-ët).

Për të gjitha objektivat, BE-ja do të koordinohet ngushtë me organizatat e shoqërisë civile të grave, donatorët e tjerë dhe partnerët zbatues. Për sa i përket procesit legjislativ, PSBE-ja do të koordinojë dhe do t'u dërgojë autoriteteve lokale komentet e BE-së mbi legjislationin që trajton mosdiskriminimin dhe dhunën me bazë gjinore.



## **PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE SEKSUALE DHE RIPRODHUESE**

Objektivat e GAP III të Fushës Tematike 2 kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, të drejtat themelore dhe demokracinë sipas IPA III. Ata do të kontribuojnë në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, Objektivi specifik 2.3:

- “1. Mundësimi i mjedisit ligjor, politik dhe shoqëror që u mundëson grave dhe vajzave të kenë qasje në kujdesin dhe shërbime cilësore të shëndetit seksual dhe riprodhues (SRHR) dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre seksuale dhe riprodhuese”, përmes dialogut politik, si dhe edukimit të IPA-s të mbështetur nga BE-ja, Programit IPA për Shoqërinë Civile dhe Median-programe të CSFMP dhe Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut-programe të EIDHR.  
BE-ja do të bashkëpunojë ngushtë me OBSH-në, UNFPA-në, UNOPS-in, Sida-n dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA.
- “2. Përmirësimi i qasjes për çdo individ në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese, duke përfshirë shërbimet e planifikimit familjar, informacionin dhe edukimin mbi të

drejtat seksuale dhe riprodhuese” përmes Programit të Shoqërisë Civile dhe Medias-CSFMP, Veprimi për mbrojtjen sociale IPA 2019 të zbatuar nga Save the Children, duke bashkëpunuar me Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA dhe Sida-n.



## PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE, FUQIZIMI I VAJZAVE, GRAVE

Objektivat e GAP III të Fushës Tematike 3 kanë të bëjnë me konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse sipas IPA III dhe janë të harmonizuara me objektivat specifike të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 1.1, 1.2 dhe 2.1:

- “1. Rritja e qasjes për gratë, në të gjithë diversitetin e tyre, në punën e denjë, duke përfshirë kalimin e grave në ekonominë formale dhe mbulimin nga sistemet jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale”, përmes mbështetjes për ndryshimin e legjislacionit të punës, mbështetjes për punësim të IPA-s, shërbimeve sociale, komuniteteve, dhe Programi për Shoqërinë Civile dhe Median-Veprime të CSFMP. Kjo përfshin bashkëpunim të ngushtë me USAID-in, Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA, Sida-n, Holandën, GIZ-n, Sllovakinë, ILO-n (Organizata Ndërkombëtare për Punë), UNOPS-in, UNHCR-në dhe UNDP-në.
- “2. Përmirësimi i politikave, kornizës ligjore dhe qasjes në shërbimet e kujdesit duke mundësuar ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave dhe burrave”, përmes dialogut politik dhe financimit të arsimit nga IPA.
- “3. Rritja e qasjes për gratë në të gjithë diversitetin e tyre ndaj shërbimeve dhe produkteve financiare dhe burimeve produktive”, përmes konkurrencës së IPA-s dhe financimit të komuniteteve në bashkëpunim me USAID-in, Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA, UNDP-në dhe Sida-n.
- “4. Gratë në të gjithë diversitetin e tyre kanë përmirësuar qasjen në mundësitë e ndërmarrësisë, duke përfshirë ndërmarrësinë sociale, mjetet alternative të jetesës dhe pjesëmarrjen e forcuar në ekonominë e gjelbër dhe qarkore”, përmes programimit të konkurrencës IPA, në bashkëpunim me UNDP-në, IOM-in, UNOPS-in, GIZ-in, Sllovakinë dhe Sida-n.
- “5. Përmirësimi i qasjes për gratë në të gjithë diversitetin e tyre në rolet menaxheriale dhe drejtuese në sektorët dhe forumet sociale dhe ekonomike”, përmes programimit të konkurrencës IPA dhe mbështetjes së BE-së për bizneset fillestare (IPA 2018, IPA 2020).
- “6. Reduktimi i pabarazive gjinore në regjistrim, përparim dhe mbajtje në të gjitha nivelet e arsimit dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë”, përmes programeve arsimore IPA, së bashku me USAID, Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA dhe UNOPS.
- “7. Përmirësimi i kornizës rregullative për sigurimin e qasjes së barabartë në shërbimet e kujdesit shëndetësor fizik dhe mendor parandalues, kurues dhe rehabilitues cilësor universal dhe publik për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, duke përfshirë edhe në situata krize”, përmes dialogut politik dhe Programit të Institucionit të Shoqërisë Civile dhe Medias-CSFMP.
- “8. Përmirësimi i qasjes në ujë të sigurt dhe shërbime sanitare, të ndara të paktën sipas gjinisë” përmes IPA.



## PROMOVIMI I PJESËMARRJES DHE LIDERSHIPIT TË BARABARË

Objektivat e GAP III të Fushës tematike 4 kanë të bëjnë me IPA III në lidhje me qeverisjen e mirë dhe do të kontribuojnë në objektivin 3.2 të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore:

- “1. Mundësimi i kushteve të krijuara për pjesëmarrje të barabartë të grave, burrave, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrje”, përmes dialogut politik dhe Programit IPA të Shoqërisë Civile dhe Medias-CSFMP.
- “2. Gratë dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, kanë përmirësuar qasjen në drejtësi për të mbrojtur të drejtat e tyre civile dhe politike”, përmes IPA për sundimin e ligjit dhe IPA për Shoqërinë Civile dhe Programin e Medias - CSFMP, dhe Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut-EIDHR, duke bashkëpunuar me aktivitetin e monitorimit dhe raportimit të EULEX-it, USAID-in, Agjencinë Austriake për Zhvillim, Sida-n, Holandën, UNDP-në dhe UN Women.
- “3. Organizatat e grave, OSHC-të e tjera dhe gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut që punojnë për barazinë gjinore dhe fuqizimin dhe të drejtat e grave dhe vajzave, punojnë më lirshëm dhe mbrohen më mirë me ligj”, nëpërmjet dialogut politik, IPA për Shoqërinë Civile dhe Programit të Medias-CSFMP dhe Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut-EIDHR, së bashku me Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA dhe Sida-n.



- “4. Normat e barabarta shoqërore, qëndrimet dhe sjelljet që promovojnë pjesëmarrjen dhe udhëheqjen e barabartë të nxitura në nivel komuniteti dhe individual përmes edukimit qytetar, medias, arsimit dhe kulturës në të gjitha nivelet”, nëpërmjet dialogut politik, informimit dhe Programit IPA për Shoqërinë Civile dhe Median - CSFMP. Kjo do të jetë në koordinim me Sida-n, Agjencinë Austriake për Zhvillim-ADA, GIZ-in, Holandën, Slloveninë, UN Women, UN Habitat-in, EULEX-in dhe UNDP-në.



## INTEGRIMI I AGJENDËS PËR GRA, PAQE DHE SIGURI

Objektivat e GAP III të Fushës Tematike 5 kanë të bëjnë me të gjithë IPA III, veçanërisht me qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, të drejtat themelore dhe bashkëpunimin territorial dhe ndërkufitar. Në Kosovë, të gjitha objektivat e GAP III janë relevante: 1) Pjesëmarrja, 2) Integrimi gjinor, 3) Udhëheqja sipas shembullit, 4) Parandalimi, 5) Mbrojtja dhe 6) Ndihma dhe Rimëkëmbja.

Progresi drejt zbatimit të këtyre përputhet me [Planin e Veprimit të BE-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë 2019-2024](#) dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore Objektivi Specifik 3.3, ndër të tjera.

ZBE-ja dhe PSBE-ja angazhohen në avancimin e dialogut politik të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës gjinor përmes mbështetjes financiare të programeve të lidhshme të grave dhe dialogut politik me qeverinë. EULEX-i do të vazhdojë të promovojë pjesëmarrjen e grave në institucionet e sigurisë, veçanërisht në polici dhe shërbime korrektuese. BE-ja do të bashkëpunojë edhe me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Koordinatorin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UN Women, UNDP, GIZ, Slloveni, Ambasadën Britanike dhe organizatat e shoqërisë civile të grave të fokusuar në zbatimin e Rezolutës 1325.



## TRANZICIONI I GJELBËR DHE DIGJITALIZIMI

Objektivat e GAP III të Fushës Tematike 6 kanë të bëjnë me agjendën e gjelbër dhe lidhjen e qëndrueshme të IPA III:

- “1. Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre në proceset vendimmarrëse për çështjet e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike”, nëpërmjet të gjithë programeve mjedisore dhe dialogut politik IPA, në bashkëpunim me Sida-n, UN Habitat-in dhe UNDP-në.
- “2. Strategjitë dhe marrëveshjet për zbutjen e klimës, përshtatjen, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biodiversitetit janë më të përgjegjshme ndaj gjinisë”, nëpërmjet programimit mjedisor dhe dialogut politik, duke bashkëpunuar ngushtë me Sida-n, UN Habitat-in dhe UNDP-në.
- “3. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, adresimi i ndryshimeve klimatike në jetën e tyre të përditshme dhe ruajtja e mjedisit natyror njihen dhe vlerësohen”, përmes programimit mjedisor IPA dhe Programit të Shoqërisë Civile dhe Medias-CSFMP.
- “4. Gratë dhe burrat në të gjithë diversitetin e tyre, marrin pjesë gjithnjë e më shumë dhe kanë përmirësuar qasjen në vende pune, mundësitë për ndërmarrësi dhe jetesën alternative në ekonominë e gjelbër dhe ekonominë qarkore”, nëpërmjet programeve të mjedisit IPA dhe konkurrencës në bashkëpunim me Sida-n.
- “5. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, marrin pjesë në mënyrë të barabartë në politikë-bërje dhe vendim-marrje për botën digjitale, në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, dhe përfaqësohen në këto politika dhe vendime”, nëpërmjet programit të IPA-s për tranzicion digjital dhe për edukim.
- “6. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në të gjithë diversitetin e tyre kanë qasje të barabartë në broadband, teknologji dhe mjete digjitale të përballeshme dhe të sigurta”, përmes programimit IPA për konkurrencë dhe mbështetje për bizneset fillestare.
- “7. Grave, burrave, vajzave dhe djemve u sigurohet dhe përdorin në mënyrë të barabartë edukimin digjital publik”, përmes programimit IPA për konkurrencë.
- “8. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në të gjithë diversitetin e tyre marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në ekonominë digjitale”, nëpërmjet programimit të ekonomisë qarkore, në bashkëpunim me GIZ.

## POTENCIALI PËR SINERGJI

Janë identifikuar disa sinergji dhe mundësi bashkëpunimi në lidhje me secilin nga objektivat e përzgjedhura të lartpërmendura. BE-ja do të vazhdojë si anëtare aktive e Grupit shumëpalësh për Siguri dhe Gjini (i kryesuar nga UN Women), do të ketë koordinim të rregullt të donatorëve në kontekstin e takimeve të MS+ dhe do të koordinojë për barazinë gjinore përmes koordinimit me këshilltarët gjinorë të organizatave ndërkombëtare (OKB, OSBE, KiE, EULEX dhe KFOR). Kjo do të kërkojë edhe të identifikojë sinergji dhe mundësi shtesë për koordinim drejt barazisë gjinore. BE-ja do të mbështesë Agjencinë për Barazi Gjinore për të kontribuar në një koordinim më sistematik, më të strukturuar dhe strategjik ndërmjet institucioneve, BE-së, OKB-së, OSBE-së, EULEX-it, donatorëve të tjerë, si dhe shoqërisë civile.

## PËRFSHIRJA E OSHC-ve

Në përputhje me “Udhërrëfyesin e BE-së për angazhimin me OSHC-të”, BE-ja do të sigurojë angazhim të vazhdueshëm të OSHC-ve të ndryshme në proceset e projektimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit në lidhje me këtë PZNV. Kjo do të përfshijë OSHC-të e grave që punojnë me gra me prejardhje të ndryshme, duke përfshirë minoritetet etnike, gratë rurale dhe me aftësi të ndryshme. OSHC-të janë konsultuar në hartimin e kësaj PZNV-je dhe është përfshirë kontributi i tyre. Gjithashtu, gjatë fazave të planifikimit, përmes dialogut politik, BE-ja do të inkurajojë fuqimisht Qeverinë e Kosovës që të përdorë platformat e konsultimit publik për të konsultuar OSHC-të e ndryshme lidhur me përmbajtjen e ndryshimeve ligjore dhe të politikave dhe atë të Dokumenteve të Veprimit IPA III. BE-ja do të inkurajojë bashkëpunimin me OSHC-të e grave nëpërmjet konsultimeve të rregullta. Programi IPA për Shoqërinë Civile dhe Mediat do të mbështesë edhe zbatimin e objektivave të GAP III, siç është detajuar. Si pjesë e termave të referencës për vlerësimet e programeve, BE-ja do të inkurajojë vlerësuesit që të takohen me OSHC-të për të mbledhur vështrimet e tyre mbi zbatimin e angazhimeve të barazisë gjinore të bëra në programe.

Lidhur me dialogun politik sipas objektivave të lartpërmendura, dhe në përputhje me Rezolutën 1325 të KS të OKB-së, BE-ja do të takohet rregullisht me OSHC të ndryshme për të diskutuar çështjet prioritare politike, duke mbledhur kontributin e tyre. BE-ja do të kërkojë të bashkëpunojë ngushtë me OSHC-të në avokimin e tyre politik në lidhje me avancimin e barazisë gjinore, veçanërisht në lidhje me ndryshimet përkatëse ligjore dhe të politikave.

## VEPRIMET E SYNUARA QË MBËSHTETIN BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE

GAP III synon rritjen e numrit dhe efektivitetit të veprimeve me barazinë gjinore si objektivi kryesor (Instrument i OBEZH [G2](#)). Kontratat e mëposhtme të G2 do të zbatohen midis 2021 dhe 2025:

- Kontrata 404465 (data e përfundimit 2022, kontributi i BE-së 540,000 euro): “Forcimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë”, implementuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK). **Fushë tematike:** Promovimi i pjesëmarrjes dhe lidershit të barabartë; **Objektiv:** disa; **Treguesit kryesorë:** Përqindja e ulëseve të mbajtura nga gratë në (a) parlamentet kombëtare dhe (b) pushtetet lokale; numri i organizatave për të drejtat e grave, organizatave për ndërtimin e paqes, organizatave feministe dhe organizatave të grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut që morën pjesë në konsultime rreth politikave të reja dhe draft legjislativ me aktorët shtetërorë/e qeverisë rajonale, kombëtare dhe lokale.
- Kontrata 419484 (data e përfundimit 2022, kontributi i BE-së 276,607 euro): “Pajisja, fuqizimi dhe punësimi i të rinjve, grave dhe grupeve të tjera të pafavorizuara në pesë komuna”, zbatuar nga Syri i Vizionit. GAP III **Fushë tematike:** Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale dhe fuqizimi i vajzave dhe grave; **Objektivi:** “Rritja e qasjes së grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në punë të denjë, duke përfshirë kalimin e grave në ekonominë formale dhe mbulimin nga sistemet e mbrojtjes sociale jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse”; **Treguesit:** Shkalla e punësimit, e ndarë të paktën sipas gjinisë; dhe niveli i pajtueshmërisë kombëtare me të drejtat e punës (liria e organizimit dhe kontrata kolektive) bazuar në burimet tekstuale të ILO-s dhe legjislativin kombëtar, sipas gjinisë dhe statusit të migrantit (SDG 8.8.2).
- Kontrata 419479 (data e përfundimit 2022, kontributi i BE-së 99,184 euro): Qendra Rinore Shumëfunktionale “ARKA”, zbatuar nga THY UDRUZENJE. **Fushë tematike:** Promovimi i të

drejtave ekonomike dhe sociale dhe fuqizimi i vajzave dhe grave; **Objektivi:** “Gratë në të gjithë diversitetin e tyre kanë përmirësuar qasjen në mundësitë e ndërmarrësisë, duke përfshirë ndërmarrjen sociale, mjetet alternative të jetesës dhe pjesëmarrjen e forcuar në ekonominë e gjelbër dhe qarkore”; **Treguesit:** Shkalla e punësimit, e ndarë të paktën sipas gjinisë; dhe numri i grave përfituese të shërbimeve të zhvillimit të biznesit që kanë regjistruar biznesin e tyre, duke përfshirë ndërmarrjet sociale.

- Kontrata 419468 (data e përfundimit 2022, kontributi i BE-së 97,450 euro): Dyqan bamirës për punësimin e të rinjve dhe mbrojtjen e mjedisit, implementuar nga Lëvizja YMCA në Gjakovë. **Fushë tematike:** Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale dhe fuqizimi i vajzave dhe grave; **Objektivi:** Gratë në të gjithë diversitetin e tyre kanë përmirësuar qasjen në mundësitë e ndërmarrësisë, duke përfshirë ndërmarrësinë sociale, mjetet alternative të jetesës dhe pjesëmarrjen e forcuar në ekonominë e gjelbër dhe qarkore; rritje e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre në proceset vendimmarrëse për çështjet e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike; **Treguesit:** Shkalla e punësimit, e ndarë të paktën sipas gjinisë; numri i grave përfituese të shërbimeve të zhvillimit të biznesit që kanë regjistruar biznesin e tyre, përfshirë ndërmarrësinë sociale; dhe numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, aktivistë dhe mbrojtës të të drejtave mjedisore që veprojnë si agjentë të ndryshimit për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të ndjekur drejtësinë mjedisore, në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal, të ndara të paktën sipas gjinisë.
- Kontrata 415391 (data e përfundimit 2022, kontributi i BE-së 70,000 euro): “Ofrimi i mbështetjes për zbatimin e GAP II dhe integrimin gjinor”, zbatuar nga RrGK. Instrument teknik.
- Për t’u kontraktuar: Instrumenti për Barazinë Gjinore **Fushë tematike:** barazia gjinore, ofrimi i shërbimeve, hartimi ligjor, ngritja e kapaciteteve etj. **Objektivat:** Kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave, integrimin e çështjeve gjinore në ligje dhe politika, forcimin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të institucioneve të Kosovës në nivel lokal dhe qendror, përmirësimin e komunikimit, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet mekanizmave të barazisë gjinore duke përfshirë shoqërinë civile, ndërgjegjësimin, etj.
- Për t’u kontraktuar: Zhvillimi i kapaciteteve dhe mbështetja financiare për OSHC-të që punojnë për barazinë gjinore në mes të pandemisë COVID-19 dhe pasojave të saj dhe më gjerë. Projekti do të forcojë kapacitetin e OSHC-ve për t’u përfshirë në proceset vendimmarrëse dhe reformat e politikave, veçanërisht në lidhje me përgjigjen ndaj krizës socio-ekonomike që rezulton nga pandemia e koronavirusit, përmes dhënies së granteve të vogla dhe zhvillimit të kapaciteteve për OSHC-të e grave, duke mundësuar shtrirje, operacione dhe ndikim të përmirësuar në mes të pandemisë së koronavirusit dhe pasojave të saj.
- Për t’u kontraktuar: OSHC-të e grave dhe aktivistet do të marrin mbështetjen e BE-së përmes mekanizmave të ridhënies së granteve dhe përmes granteve të veprimit të dhëna pas thirrjeve për propozime në kornizën e Programit IPA për Shoqërinë Civile dhe Medias-CSFMP 2021-23.

Programet e G2 të financuara në nivel rajonal nga BE-ja po kontribuojnë edhe në disa objektiva të PZNV të Kosovës:

- Kontrata 420117 “Përfundimi i dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, Faza II. **Zbatimi i normave, ndryshimi i mendjes**” zbatuar nga UN Women;
- Kontratë 394402 (data e përfundimit 2022): “Fuqizimi i OSHC-ve në Luftimin e Diskriminimit dhe Përmirësimi i të Drejtave të Grave në Punë”, zbatuar nga RrGK në Kosovë;
- Kontrata 414-028 (data e përfundimit 2024): “Përmirësimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE”, zbatuar nga RrGK në Kosovë.

## ANGAZHIMI NË DIALOG PËR BARAZI GJINORE DHE FUQIZIM TË GRAVE

BE-ja do të përdorë dialogun politik në të gjitha fushat tematike, drejt progresit në objektivat e lartpërmendura. Kjo do të përfshijë takimet e Komitetit dhe Nënkomitetit të MSA-së, takimet periodike dhe *ad hoc* të dialogut me zyrtarët e Kosovës, kontributin në hartimin e legjislacionit, ofrimin e komenteve për projektligjet dhe politikat, dhe të folurit në ngjarje publike në përgjithësi, si dhe ato të organizuara në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës. BE-ja do të kërkojë të sigurojë që çështjet e barazisë gjinore të ngrihen gjatë këtyre dialogëve politikë, si pjesë e agjendave, pikave të të folurit dhe konkluzioneve. Çështjet që do të trajtohen përfshijnë pabarazitë kryesore gjinore dhe objektivat drejt barazisë gjinore të identifikuar në këtë PZNV. BE-ja do të organizojë takime të rregullta me gra

udhëheqëse në sektorë të ndryshëm, përfaqësuese gra në politikë dhe OSHC të ndryshme të grave për të dëgjuar prioritetet e tyre dhe për të diskutuar se si BE-ja mund të mbështesë ngritjen e çështjeve drejt barazisë gjinore. BE-ja do të vazhdojë të kryesojë grupin gjinor të vendeve anëtare të BE-së +EULEX-i dhe do të takohet të paktën çdo tremujor.

#### AFRIMI DHE KOMUNIKIME TË TJERA / AKTIVITETE TË DIPLOMACISË PUBLIKE

BE-ja do të kërkojë të ngrejë çështjet e barazisë gjinore gjatë ngjarjeve publike, veçanërisht përmes përfshirjes së çështjeve gjinore në fjalime dhe në pika diskutimi. Për më tepër, BE-ja planifikon të organizojë të paktën një fushatë informuese publike çdo vit mbi një temë që lidhet me barazinë gjinore. Kjo do të konsultohet me OSHC-të e grave, përfaqësueset gra në politikë, EULEX-in, vendet anëtare të BE-së në Kosovë dhe agjencitë e OKB-së.

#### INSTRUMENT TEKNIK DHE/OSE BURIME FINANCIARE TË ALOKURARA PËR TË MBËSHTETUR ZBATIMIN E GAP III

BE-ja ka kontraktuar Rrjetin e Grave të Kosovës RrGK nga viti 2020 deri në vitin 2022 për të mbështetur zbatimin e GAP III dhe përpjekjet e tjera drejt integritit të perspektivës gjinore në aktivitetet dhe programet e BE-së.

Kjo përfshin trajnimin e vazhdueshëm, mentorimin dhe ngritjen e kapaciteteve për stafin dhe kontraktorët e BE-së, të ofruara nga ekspertët e RrGK. BE-ja po përgatit një program Institucioni për Barazinë Gjinore që do të vazhdojë këtë punë prej vitit 2022, nën IPA 2021.

Një Veprim i CSF i financuar nga BE dhe i bashkëfinancuar nga Sida në nivel rajonal do të kryejë tri analiza gjinore specifike për sektorët në fusha tematike ku mungon analiza gjinore, të rënë dakord me BE-në dhe Qeverinë e Kosovës (paraprakisht për digjitalizimin, ekonominë joformale dhe mjedisin, siç identifikohen sipas fushave të nevojshme).